

Në bazë të nenit 54 paragrafi (1) pika 1.21, nenit 77 të Ligjit të Energjetikës\* ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.101/25 dhe 135/25) dhe nenit 27 paragrafi (3) të Rregullores së Licencave („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 40/26), Komisioni Rregullator i Energjetikës, i Shërbimeve të Ujit dhe i Shërbimeve të Menaxhimit me Mbeturina Komunale i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 19 qershor 2026, solli këtë

**VENDIM  
PËR VAZHDIMIN E LICENCËS SË PUNËS PROVË**

1. Vazhdohet licenca e punës provë nga centrali elektrik diellor CED "TRINITI ENERXHI" e dhënë për Shoqërinë e Prodhimit, të Tregtisë dhe të Shërbimeve TRINITI ENERXHI SHPKNJP import-eksport Shkup me Vendimin për Dhënien e Licencës së Punës Provë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 3/26).
2. Në shtojcë, në pikën 4, fjalët "30 qershor 2026" zëvendësohen me fjalët "30 dhjetor 2026".
3. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e sjelljes së tij dhe publikohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" dhe në faqen zyrtare të Komisionit Rregullator të Energjetikës, të Shërbimeve të Ujit dhe të Shërbimeve të Menaxhimit me Mbeturina Komunale të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

**PA1 nr. 12-268/26  
19 qershor 2026  
Shkup**

**Kryetari  
i Komisionit Rregullator të Energjetikës, të  
Shërbimeve të Ujit dhe të Shërbimeve të  
Menaxhimit me Mbeturina Komunale të  
Republikës së Maqedonisë së Veriut**

**Ацо Ристов**